

2016/PRILL

COMMENTARY



Mungesa e debatit publik mbi ekstremizmin
e dhunshëm dhe si mediat në
Maqedoni raportojnë mbi të

www.analyticamk.org

Mungesa e debatit publik mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe si mediat në Maqedoni raportojnë mbi të

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm konsiderohet të jetë një kërcënim global, pasi çdokush mund të bjerë viktimë potenciale e indoktrinimit në ideologjitë ekstremiste.

Pothuajse asnjë shtet deri tani nuk ka qenë i kursyer nga ky fenomen, dhe shtetet e ndryshme kanë zgjedhur qasje të llojllojshme për ta trajtuar këtë çështje. Në nivel ndërkombëtar fenomeni deri më tani ka qenë i trajtuar vetëm nga aspekti i sigurisë, si për shembull Koalicioni kundër ISIL-it¹ konfirmon këtë qasje, megjithatë së fundi fokusi ka filluar të zhvendoset drejt gjetjeve të zgjidhjeve më gjithëpërfshirëse. Koncepti i Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) këshillon shtetet të punojnë në krijimin e komuniteteve më të konsoliduara të cilët konsiderohen si partnerë mjaft të rëndësishëm në këtë luftë.²

¹ Deklaratë e përbashkët e lëshuar nga partnerët në takimin ministror të Koalicionit kundër ISIL-it si dhe lista e shteteve pjesëmarrëse në koalicion: <http://1.usa.gov/1HZPBdG>

² Vërejtje nga Presidenti i SHBA-ve Barak Obama në Samitin e Liderëve për CVE <https://www.whitehouse.gov/the-press-office/2015/09/29/>

COMMENTARY 2016/PRILL

Këto masa gjithëpërfshirëse mbështeten në përkrahjen e të gjitha palëve relevante që mund të kontribuojnë në ndërtimin e një zgjidhjeje e cila do të vepronte jo vetëm pasi radikalizimi të ketë nxënë vend mirëpo do të ketë edhe një rol parandalues në të gjithë konceptin e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Një hap i rëndësishëm në ndërtimin e kundër-argumenteve ndaj ideologjive ekstremiste është ndërgjegjësimi i opinionit publik për kërcënimet dhe rreziqet që vijnë nga radikalizimi. Nevojitet një debat publik, ku ekspertët, udhëheqësit fetarë dhe zyrtarët shtetërorë do të ndanin mendimet dhe njohuritë e tyre në lidhje me CVE-në, dhe do ti ballafaqonin idetë/mendimet se si dhe sa gjejnë zbatim në kontekstin vendor. Debatit publik do të ndihmonte në sqarimin e keqkuptimeve që mund të lindnin gjatë trajtimit të çështjeve të ndjeshme si kjo. Media mund të luaj rol konstruktiv, duke

[remarks-president-obama-leaders-summit-countering-isil-and-violent](http://www.whitehouse.gov/the-press-office/2015/09/29/remarks-president-obama-leaders-summit-countering-isil-and-violent), Selia e OKB-së, Nju Jork, 29.09.2015

i kushtuar vëmendje të posaçme kësaj teme, mirëpo nga ana tjetër mund të rezultojë të jetë një thikë me dy tehe, kur kjo temë trajtohet në mënyrë të pakujdesshme dhe joprofesionale.

Në Maqedoni debati publik në lidhje me çështjen e radikalizimit është ende dobët i zhvilluar dhe jo i koordinuar mirë. Që nga fillimi i 2015-ës ka pasur vetëm disa deklarata publike në dënim të këtij fenomeni, përkatësisht deklaratat e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame³, gjithashtu dhe disa deklarata nga zyrtarë të shtetit vetëm duke deklaruar se Maqedonia si shtet përballet me këtë kërcënim që vjen nga ekstremizmi i dhunshëm.⁴ Megjithatë deri tani nuk ka pasur asnjë debat të vetëm televiziv i cili do ti kushtonte kohë të veçantë kësaj teme në mënyre që të adresohet më gjerësisht për publikun. Është e rëndësishme të ceket se ekziston një emision televiziv i quajtur "Ikre" që transmeto-

³ Krerët islamë në Maqedoni duan luftimin e terrorizmin por dhe respektimin e të drejtave <http://kohane.net/?id=&l=69660>, 06.08.2015

⁴ Siguria Shtetërore në fokus të fjalimit të Presidentit Ivanov <http://bit.ly/1ZxaGUG>, 22.12.2015

het në televizionin kombëtar në kanalin e TVM2 në Programin në Gjuhën Shqipe, emision i cili përgatitet nga Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni dhe trajton tema që lidhen me fenë Islame. Mirëpo, për fat të keq ky emision nuk është i promovuar mjaftueshëm dhe si i tillë nuk ndiqet mjaftueshëm nga publiku i gjërë, dhe poashtu deri tani nuk ka mbajtur asnjë diskutim dedikuar veçanërisht temës së ekstremizmit të dhunshëm.

Nga ana tjetër, mediat e shkruara dhe internet portalet kanë shkruar shumë mbi temën e DAESH-it, por këtyre medimeve shpesh u mungon aftësia për t'i vënë çështjet në perspektivë. Ato kryesisht raportojnë vetëm fakte të thata, përdorin terminologji që konsiderohen të jenë të gabuara ose publikojnë tituj sensacionalë që përkundrazi vetëm mund të shtojnë tensione. Mungesa e gazetarëve të profesionalizuar në çështje të sigurisë kontribuon më tepër që kjo temë të trajtohet në mënyrë joadekuate.

Gabimi i dytë më i zakonshëm që ndodh është tendenca që fenomeni i radikalizimit të lidhet vetëm me një komunitet etnik. Sipas statistikave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, 33% e popullsisë në Maqedoni konsiderohet të jetë

muslimane, ndërsa shqiptarët në Maqedoni, të cilët më së shpeshti lidhen me këtë fenomen, përbëjnë vetëm 25% të popullsisë.⁵ Aksioni policor "Celula" me tej dëshmoi se nuk ka model apo shembull i prouvar se kush radikalizohet dhe se ky fenomen nuk kap domosdoshmërisht vetëm një komunitet etnik në Maqedoni, pasi që një pjesë e personave të arrestuar i përkisnin komuniteteve tjera etnike, siç kishte në mesin e tyre edhe etnikë maqedonë apo maqedonë myslimanë të arrestuar.⁶

Ka shembuj të tjerë ku mediat lidhin raste krejtësisht që nuk kanë kurrfarë lidhjeje me ISIS-in (DAESHin). Raste të tilla u vërejtën gjatë protestave të ndryshme gjatë vitit të kaluar që u zhvilluan kundër qeverisë aktuale, ku disa portale të lajmeve u shfaqën me tituj bombastik, sikur "mbështetësit e ISIS-it iu bashkangjitën protestave qytetare".⁷

Titujt e tillë duhen të shmangen në mënyrë të patjetërsueshme nga ana e gazetarëve. E njëjta gjë vlen edhe për videot propagandistike që ngarkohen vazhdimisht nëpër internet portalet e lajmeve të vendit në mënyrë që të tërhiqet më shumë klikime nëpër faqet e tyre, këto internet portale janë kundër-produktive pasi që kontribuojnë në përhapjen e propagandës dhe radikalizimit duke ekspozuar qytetarët akoma më shumë me materiale që kryesisht përdoren për të tërhequr rekrutë të mundshëm.⁸

Interneti ju ofron ekstremistëve të dhunshëm mjete të fuqishme në përhapjen e urrejtjes dhe dhunës dhe në identifikimin dhe përgatitjen e rekrutëve potencial, duke krijuar komunitete globale në internet që nxisin ra-

dikalizmin. Përveç kësaj është fakt i njohur, se materialet propagandistike shpeshherë përkthehen në gjuhët lokale, dhe duke mos pasur një debat publik, ku udhëheqësit fetarë do ti identifikonin ato mesazhe të dëmshme që qarkullojnë dhe do të ndërtonin kundër-argumentet, e gjithë kjo vënë së bashku me faktin se Bashkësia Fetare Islame nuk është shumë aktive dhe prezente të angazhohen me të rinjtë nëpër mediat sociale, publiku i gjerë, veçanërisht të rinjtë, janë lënë të pambrojtur dhe lehtë të cënueshëm.

Shfaqja dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes në internet është një fenomen i ri që zhvillohet shpejtë dhe janë të nevojshme përpjekje kolektive për të kuptuar rëndësinë dhe pasojat e saja, në mënyrë që të zhvillojmë kundërpërgjigje sa më efikase. Prandaj nevoja për iniciimin e një debati gjithëpërfshirës në Maqedoni në këtë temë është mëse emergjente.

SHKRUAR NGA, KALTRINA SELIMI

kselimi@analyticamk.org
Hulumtuese në programin për Çështje të Jashtme dhe të Sigurisë

Analytica
Thinking Laboratory
www.analyticamk.org
info@analyticamk.org



5 Profili Demografik i Maqedonisë:
http://www.indexmundi.com/macedonia/demographics_profile.html

6 Akcioni "Celula": Shkupi qendra kryesore për rekrutimin e luftëtarve për në Siri <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-295685-akcija-kelija-skopje-bil-glaven-regrutentcentar-za-borci-vo-sirija.nspix>, 06.08.2015

7 Përkrahës të Hamas-it, Al Aksës në protestat në Shkup <http://puls24.mk/mk/vesti/podrzuvaci-na-hamas-al-aksa-na-protestite-vo-skopje-zaev-i-muslimansko-bratstvo-pustosat-niz-glavniot-grad>, 25.04.2016

8 Shembull i një titulli sensacional: ISIS bën thirrje për xhihad në pushtimin e Stambollit! (VIDEO)
<http://www.gazetaexpress.com/lajme/isis-ben-thirrje-per-xhihad-ne-pushtimin-e-stambollit-vid-eo-123654/?archive=1>, 18.08.2015